



BASHKIA MIRDITË

NJOFTIM

SUBVENCIONIMI I BONUSIT TË QIRASË, SIPAS LIGJIT NR. 22/2018 “PËR STREHIMIN SOCIAL”

Bashkia Mirditë njofton qytetarët se është hapur thirrja për aplikime për përfitimin e programit “Subvencionimi i bonusit të qirasë” në zbatim të Ligjit nr. 22/2018 “Për Strehimin Social”, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 426, datë 27.6.2018, “Për miratimin e kriterëve, procedurave dhe mënyrës së përfitimit të formave të mbështetjes për strehim”.

Programi i subvencionimit të bonusit të qirasë ka për qëllim mbështetjen e familjeve dhe individëve në nevojë për sigurimin e banesës, nëpërmjet subvencionimit të një pjese të qirasë mujore për banesën e marrë me qira në treg të lirë.

1.1 Kriteret e përfitimit bonus qiraje

- Nuk kanë në pronësi një banesë të përshtatshme për banim;
- Nuk janë përfitues të një forme tjetër mbështetjeje për strehim nga shteti;
- Kanë të ardhura familjare nën kufirin e përcaktuar nga ligji;
- Janë banorë të njësisë administrative ku aplikojnë;
- Kanë një kontratë qiraje të regjistruar pranë organeve tatimore.

1.2 Kategoritë e Përfituesve sipas Ligjit Nr. 22/2018

1. Familjet me të ardhura të ulëta;
2. Të pastrehët;
3. Familjet që jetojnë në kushte të papërshtatshme strehimi;
4. Familjet me kryefamiljare gra;
5. Personat e vetëm me të ardhura të ulëta;
6. Familjet që kanë në përbërje persona me aftësi të kufizuara;
7. Të moshuarit pa përkrahje;
8. Jetimët e dalë nga institucionet e përkujdesjes;
9. Viktimat e dhunës në familje;
10. Viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore;
11. Familjet ose individët që janë kthyer nga emigracioni dhe ndodhen në vështirësi ekonomike;
12. Familjet ose individët që janë prekur nga fatkeqësi natyrore ose aksidente të rënda;
13. Punonjësit e shërbimeve publike që transferohen për shkak të detyrës dhe nuk kanë banesë në njësinë ku punojnë;

14. Familjet ose individët që janë strehuar përkohësisht në ambiente të përkohshme nga bashkia;
15. Familjet ose individët që kanë humbur banesën si rezultat i prishjes së objekteve në proces legalizimi apo zhvillimi urban;
16. Familjet që kanë në përbërje fëmijë nën kujdestari apo në proces birësimi;
17. Familjet që kanë në përbërje persona që përfitojnë nga ndihma ekonomike apo pensioni social.

1.3 Dokumentacioni i Nevojshëm për Aplikim (Bonus qiraje).

- Aplikimi në E-albania të çdo aplikanti të formularit të strehimit
- Fotokopje e kartës së identitetit për çdo anëtar madhor të familjes;
- Çertifikatë familjare (gjendje familjare e përditësuar);
- Çertifikatë personake e aplikantit
- Vërtetim të ardhurash për çdo anëtar madhor nga institucioni përkatës (paga, pension, ndihmë ekonomike, etj.);
- Vërtetim nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (Hipoteka) që aplikuesi nuk zotëron pasuri të paluajtshme;
- Vërtetim nga Drejtoria e Tatimeve që aplikuesi nuk është regjistruar si pronar biznesi;
- Kopje të kontratës së qirasë të regjistruar pranë organeve tatimore;
- Dokumente shitesë që vërtetojnë kategorinë përkatëse (p.sh. certifikatë aftësie të kufizuar, vendim gjykate për dhunë në familje, vërtetim nga institucioni për jetimë, dokument për dëmtim banese nga fatkeqësi natyrore, etj.

1.4 Afati i Aplikimit.

Aplikimet do të pranohen deri më 20.12.2025 pranë Bashkisë Mirditë.